



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI
POLITEKNIK I TIRANËS

Nr. 673 .Prot., datë, 04/03 /2025



UNIVERSITETI
BUJQËSOR I TIRANËS

Nr. 897 .Prot., datë, 06/03 /2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS (UPT)
DHE
UNIVERSITETIT BUIQËSOR TË TIRANËS (UBT)

Nisur nga interesi i përbashkët për bashkëpunim dhe shkëmbimin e përvojave dhe njohurive në zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit, si dhe në kuadër të përpjekjeve për të zgjeruar kontaktet midis universiteteve;

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), me adresë Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, i përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Dr. Akli Fundo**

Dhe

Universiteti Bujqësor i Tiranës, me adresë Rruga “Pajsi Vodica”, Kodër- Kamëz, Tiranë, i përfaqësuar nga **Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku**

Bien dakord për të nënshkruar këtë marrëveshje të bashkëpunimit si më poshtë:

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 1, neni 3 dhe në vazhdim.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi i një kuadri për bashkëpunim ndër-institucional midis të dy institucioneve akademike, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre; përcaktimin e prioritetëve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta. Marrëveshja synon thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në fushën akademike dhe kërkimin shkencor, në fushën e zhvillimit të aktiviteteve të lidhura me shkëmbimin e personelit akademik, kërkuesve dhe studentëve, si dhe në fusha të tjera me interes të dyanshëm.

Neni 3

Parime bazë

Parimi themelor rregullues për bashkëpunimin midis institucioneve është autonomia akademike dhe universitare. Ato bashkëpunojnë duke respektuar njëra tjetrën në vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligj dhe akte nënligjore, duke ruajtur dhe zhvilluar përvojën më të suksesshme, përmes nismash, projektsh dhe veprimtarish të përbashkëta akademike e universitare.

Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre Palët pranojnë zbatimin e Kodit European të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagjiaturës dhe pseudoshkencës.

Neni 4

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi midis Palëve shtrihet në të gjitha fushat e punës kërkimore dhe akademike, si dhe në të gjitha fushat me interes të përbashkët, që përfshihen në misionin e institucioneve të arsimit të lartë të Shqipërisë, duke pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi dhe miratimin e të dy universiteteve, përmes aktiviteteve të tilla ose programeve që kanë të bëjnë me:

1. Zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën akademike dhe kërkimore;
2. Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si; konferenca, forume, simpoziume etj.
3. Kyerjen e studimeve të përbashkëta;
4. Aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore,
5. Nxitjen dhe promovimin e studiuesve të rinj;
6. Hartimin e strategjive të zhvillimit dhe akteve normative në zbatim të tyre;
7. Bashkëpunim dhe kontribut në sigurimin e burimeve humane dhe ekspertizës së nevojshme në fushën e inxhinierisë elektrike, teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë së ndërtimit në funksion të mbarëvajtjes së programit mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni në Bujqësi dhe Mjedis që do të hapet në UBT;
8. Bashkëpunim për ofrimin e programeve të studimit dhe ndërmarjen e kërkimeve shkencore për aplikimin e Teknologjisë së Informacionit dhe digjitalizimit në fushën e bujqësisë dhe shkencave të jetës".

9. Shkëmbimet kërkimore dhe programet që do të zhvillohen sipas kësaj marrëveshje, në të cilën mund të përfshihen studentë, profesorë, studiues, staf administrativ si dhe burime të tjera të nevojshme për realizimin e projekteve kërkimore në kuadër të këtij bashkëpunimi;
10. Shkëmbimin e personelit akademik për dhënien e leksioneve /seminareve në lëndët apo modulet që ata i gjykojnë me interes, sipas kushteve dhe mundësive;
11. Shkëmbimin e botimeve akademike apo periodike;
12. Pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari të përbashkëta studimore, kërkimore dhe shkencore;
13. Informim reciprok për organizimin e konferencave shkencore nga ana e palëve ose në bashkëpunim me fakultetet, si dhe inkurajimin e personelit akademik në këto veprimtari;
14. Krijimin e mundësive dhe hapësirave për botime shkencore në revistat e institucioneve nga personeli akademik; organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me interes të përbashkët sipas kushteve dhe mundësive;
15. Krijimin e mundësive për përdorimin reciprok të bibliotekave për literaturë për personelin akademik dhe studentët e UPT dhe UBT, si dhe inkurajimin e përdorimit të teksteve mësimore në mënyrë të ndërsjelltë;
16. Përdorimin në rast nevojë të ambjenteve të caktuara të UPT apo UBT nga ana e studentëve apo e shoqatave të studentëve.

Neni 5

Detyrimet e palëve

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) dhe **Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)** marrin përsipër përbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, në respektim të dispozitave ligjore dhe strategjive të zhvillimit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Të dy Universitetet bien dakord që zbatimi i aktiviteteve të përcaktuara në pikën 4 të marrëveshjes do të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.

Neni 6

Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 vjecare nga data e nënshkrimit të saj nga titullarët e të dy institucioneve. Afati i marrëveshjes mund të shtyhet nëse palët janë dakord për rinovimin e saj me shkrim.

Në rast të mos rinovimit palët do të njoftojnë me shkrim 3 (tre) muaj para përfundimit të marrëveshjes

Ndërprerja e marrëveshjes pranohet prej palëve në rastet kur:

- Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim çënon funksionet themelore të tyre, me efekt për palën tjetër.
- Njëra nga palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cënimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Amendimet e Marrëveshjes

- Kjo marrëveshje amendohet pjesërisht ose tërësisht nëse palët bien dakord më parë midis tyre.
- Ndryshimet dhe/ose amendimet do të bëhen me shkrim dhe do t'i bashkëlidhen Marrëveshjes në formën e anekseve pas nënshkrimit nga titullarët e të dy institucioneve.

Neni 7

Protokollet e Bashkëpunimit

Me vullnetin e Palëve, kësaj marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokollet mund të nënshkruhen edhe për një veprimtari të vetme.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën pas nënshkrimit të saj nga të dy palët. Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë me të njëjtën vlerë juridike.

Palët angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Për

UNIVERSITETIN POLITEKNIK
TË TIRANËS

REKTORI

Prof. Dr. Akli FUNDO



UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË
TIRANËS

REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

